

INTERVISTË ME SHEFQET MULLAFAZLIUN

Prishtinë | Data: 7 maj, 2019

Kohëzgjatja: 92 minuta

Të pranishëm:

1. Shefqet Mullafazliu (I intervistuari)
2. Erëmirë Krasniqi (Intervistuesja)
3. Besarta Breznica (Kamera)

Simbolet e komenteve në transkriptë te komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

Pjesa e Parë

Erëmirë Krasniqi: A kishit mujtë me na tregu diçka për familjen e ju? Ku jeni rritë? Për kompozicionin familjar, për... krejt çka iu kujtohet prej, prej... çka është kujtesa ju ma hershme?

Shefqet Mullaftazliu: Okej. Jom i lindun në Prizren me 1 gusht 1943 në ni familje me babë tregtar e me nanë, të them amvise po me shkollë të mesme të atëhershme të asaj kohe 1917-18 të kryne shkollën e mesme medrese në Shkup. Me fjalë të tjera, ajo kohë qat' shkollë ka pasë. Edhe pasi ka qenë e lindun në Shkup, ani se me prejardhje prej Prizrenit, po babai i vet i cili ka qenë nifarë administratori në kohën e turkut, kanë qenë të shpërngulun prej Prizrenit në Shkup.

Prandaj edhe ajo me gjithë tezën janë shkollu atje, në Shkup. Kurse daja i cili ka qenë i lindun në Prizren e 15 vjet ma i vjetër ka qenë se nana ime, ai ka kry shkollën e mesme në Manastir të Maqedonisë. Bile, bile, rrëfimet e nanës atëherë që kanë qenë tregonte që paska qenë në ni konvikt me gjithë Ataturkun e Turqisë. E mandej Ataturku me rrjedhën e jetës t'vet ka vazhdu jetën e vet, daja i ndjerë o drejtu në Stamboll për të kry fakultetin juridik.

Në ndërkohë bohet Lufta e Parë Botërore edhe gjyshi im prej nanës transferohet për në Stamboll ku me gjithë dajën kanë qenë në Stamboll. Kurse nana me gjithë tezën edhe me dajën e vogël kthehen për në Prizren për të vazhdu jetën. Me fjalë të tjera, pas shkollimit të nanës edhe tezës. Tash ma detajisht me të tregu masi nisa prej kohës t'nanës e mandej edhe për babën tregoj...

Erëmirë Krasniqi: Jo, jepi këtij dimensionit shumë randësi, domethanë historitë të cilat u janë bartë edhe juve, të cilat ju s'i keni jetu po janë t'jujat.

Shefqet Mullaftazliu: Midis tjerash, arsye që kem qenë të gjithë fëmijtë na të shkollum, zanafilla po vjen prej nanës e cila ka qenë vet e arsimume edhe tonë kohën ka bo presion babës të ndjerë që fëmijtë të mos i len pa sy edhe pa shkollë. Unë jom fëmiu i fundit në familje. Pesë vllazën kemi qenë edhe ni motër. Vllaznit kanë vdekë, në jetë jemi motra edhe unë. Shkollën fillore e kam kry në Prizren, gjimnazin kam kry në Prizren...

Erëmirë Krasniqi: Qysh ka qenë Prizreni në atë kohë?

Shefqet Mullafazliu: Prizreni në atë kohë ka qenë... për emocionet e mia, për përjetimin tim shumë qytet i qetë, shumë qytet bujar, fisnik edhe normal edhe i bukur. Atë bukuri që ka pasë, kuptohet që sot nuk e ka se shumë sene, shumë objekte me vlerë janë rrënu, të them, ndoshta edhe qëllimisht për me mujtë me i hupë gjurmët e arkitekturës mesjetare, në të vërtetë që thojshin dikur, kinse otomane.

Erëmirë Krasniqi: E çka osht' tregimi i qytetit që është përcjellë për qat' arkitekturë?

Shefqet Mullafazliu: Tregimi i qytetit për atë arkitekturë... tash unë ma s'jam arkitekt. Muj me iu tregu se ni arkitekt vendas i Prizrenit i cili ka qenë kinse i dashurum në Prizren, ai në mënyrë shumë perfide i ka eliminu objektet shumë të vlefshme. Rasti i Shtëpisë së Mallnave në shadërvan e dokumenton atë se në atë lokacion ku ka qenë, ku kanë qenë zanatlitë e armë-punuesve, thikë-punuesve, argjentarisë e çka di une edhe zejeve tjera. Ai qëllimisht aty e vendosë Shtëpinë e Mallrave për me mujtë kinse me, me zavëndësu atë.

Përveç asaj, atëherë normal masi kom qenë edhe nxanës i gjimnazit, atëherë u bisedojke nëpër kullaret e Prizrenit edhe për çarshi, se ai kinse për me e rujtë Prizrenin kish pru ni vendim të cilin vendim komuna e ka pranë edhe e ka aprovu që pjesa e majtë e qytetit prej Lumbardhit të Prizrenit të ruhet edhe pa pëlqimin e tij mos të rrënohet edhe mos të mbindërtohet ose rindërtohet. Kurse pjesa e djathtë e qytetit, domethanë prej Lumbardhit djathtas ka rujtë vetëm Lidhjen e Prizrenit, objektin e Lidhjes së Prizrenit, Shtëpinë e Gani Dukagjinit edhe normal Hamamin e çka di unë, do objekte tjera që bash me ka krejt s'ka mujtë edhe s'ka dashtë me... se sigurisht kishte me u hetu.

Në pjesën e djathtë përfundi Lidhjes së Prizrenit ka qenë, kanë qenë disa objekte me vlerë të cilat kanë pasë ni arkitekturë të posaçme për atë kohë. Midis tjerash aty meniherë përfundi objektit që ekziston tani, objekti i lesh-punuesve edhe ka qenë ni objekt i Kazazëve, familjës Kazazi që kanë përpunu leshin. I vetmi objekt, e vetmja ofiçinë në të vërtetë punëtori ka qenë në krejt Kosovën që ka përpunu me energjinë e ujit.

E tash, tani për tani, me fjalë të tjera, prej shtëpisë së Gani Dukagjinit krejt pjesa e djathtë e qytetit o rrënu ku kanë qenë objektet historike, tradicionale të arkitekturës otomane, arkitekturës mesjetare të asaj kohe. Edhe praktikisht qashtu, kadal kadal Prizreni u transformu në ni qytet krejt tjetër. Se rruga buzë Lumbardhit nuk ka qenë atëherë, po meniherë objektet kanë qenë thujse mbi, mbi bregun e lumit.

Erëmirë Krasniqi: A flitet shumë për çfarë lloj arkitektë kanë ardhë në Prizren edhe kush i ka ndërtu?

Shefqet Mullafazliu: Atëherë kanë qenë... se ky bashkëvendas i imi, Stanko Mandiqi ka qenë, ai edhe ka ligjeru në Universitetin e Beogradit. Kuptohet, ai ka pasë atëherë autoritet edhe u ka konvenu atëherë. Tash kjo punë nuk o politike, po në arkitekturë përdoret fjala, tendencioze, praktikisht arkitekturë tendencioze për me eliminu diçka e për me mbizotëru diçka tjetër. Se krejt tjetër është nëse flitet për nifare rrjedhe ku urbanizmi e parasheh zhvillimin e çka di unë, zgjerimin e qytetit ose çfarëdo lokaliteti tjetër, në të vërtetë vendbanimi.

Shumë karakteristike osht' për shembull edhe Xhamia Arasta përballë postët. Aty ka qenë ni xhami të cilën e ka rrënu, po si monument kinse po e mban arkitekturën ka rujtë minarën. E aty ka vendosë mandej objektin e bankës së atëhershme. Aty kanë qenë përsëri zanatlitë e çka di unë, shtëpitë e banimit e qishtu me radhë.

Erëmirë Krasniqi: A ka ndodhë kjo gjatë kohës që ju u rritshit? A i shihshit ju qito transformime?

Shefqet Mullafazliu: Po, po, po. Une kom qenë student i vitit të parë kur përballë Hamamit, ku është tash Hoteli Theranda edhe posta u rrënu ato objekte edhe unë kom marrë pjesë në... si student i vitit të parë të arkitekturës me kry, me kry praktikën e studentit të arkitekturës. Me fjalë të tjera, ajo ka qenë koha e viteve 1962-'63.

Erëmirë Krasniqi: Ju thatë që në familje jeni mundu, sidomos përmes nanës është transmetu qikjo dëshira për edukim. Çka ka ndodhë me vllaznit edhe motrat e juja?

Shefqet Mullafazliu: Vëllau i madh, vëllau i madh atëherë ka kry shkollën e mesme ekonomike. Vëllau i dytë i cili ka pasë fillu i ndjeri me u shkollu në Gjakovë, Shkollën Normale, e përjashtojnë atë prej shkollës. Arsye pse ka hypë me thirrë për ramazan në minarën e xhamisë së Gjakovës ezanin. Edhe atëherë koha e partizanëve e dënojnë edhe e përjashtojnë prej shkollës. Nuk zgjatë shumë, për mos me mbetë pa shkollë ai regjistrohet në shkollën e mesme të Novi Sadit në mjekësi edhe e kryen atje si teknik i mjekësisë. Kthehet në Prizren edhe punësohet. Vëllau i tretë i cili pak ka qenë pak i dallum prej nesh, ka kry shkollën tetë vjeçare edhe nuk ka dashtë me vazhdu iu ka dhanë zanatit. Arsye se ka qenë pak si... ka dashtë jetën ma ndryshe se na që jemi shkollu. Edhe ka shku në...

Erëmirë Krasniqi: Çfarë zanati?

Shefqet Mullafazliu: Si?

Erëmirë Krasniqi: Çfarë zanati? A ka pasë mundësi me...

Shefqet Mullafazliu: Po de, po. Si zanatli u mundu niherë me u marrë me punën e argjentarisë, po s'ka pasë fort durim me ndejtë mbi atë edhe punësohet si nxanës te ni mjeshtër i këpuctarisë. Edhe ka kry atë zanat, shkon në ushtri. Shkon në Slloveni me kry detyrën e ushtrisë i pëlqej jeta atje edhe si të

kthehet në Prizren, lypë leje prej prindërve qysh ka qenë atëherë adeti, prej babës lypë edhe thotë, “Unë po du me vazhdu zejën e zanatit atje se shumë ma përparimtare, shumë ma e avancume atje puna e këpuctarisë” edhe shkon në Rijekë. Tanë kohën ka qenë në Rijekë, e kur i vjen koha për martesë kthehet në Prizren. Martohet e merr shoqën e vet dhe vazhdon jetën në Rijekë. Ai i ndjeri dy djem e ni çikë i ka lanë mas veti e vet në moshën 58 vjeçare ka ndrru jetë.

Motra ka kry shkollën, gjimnazin. Vëllau mas motrës, domethanë para meje, edhe ai shkollën fillore, gjimnazin në Prizren e mandej ka shku te vëllau në Rijekë në fakultetin e mjeksisë. Atje ka kry fakultetin e mjeksisë edhe si mjek u kthy në Prizren ka shërby ku edhe ka ndrru jetë. Unë pasi që kryva shkollën e mesme gjimnazin e atëhershëm, konkurova në arkitekturë në Ljublanë po pengesa e gjuhës, e mosdijës të gjuhës u ktheva në Zagreb për me mujtë me vazhdu. Atje u pranova po edhe aty kur pash se ekonomikisht nuk jom... se ni vëlla veç studiojke në Rijekë, ishte ngarkesë e madhe për prindtë. Me nifarë mënyre u ktheva në Beograd, po në Beograd nuk më pranun se jom vonu. Ishin atëherë provimet pranuese.

Kthehem në Shkup, paraqitem në provim pranohem në arkitekturë edhe aty vazhdova studimet ku masandej më 1969 kom kry fakultetit po arsyeja e vonesës së fakultetit ka qenë tërmeti i Shkupit. Se me 1963 në qershor u bo tërmeti i Shkupit ku fakulteti edhe jeta në Shkup u paralizu.

Erëmirë Krasniqi: A ishit ju atje?

Shefqet Mullafazliu: Jo, unë isha tu përgatit provimet në Prizren po dridhjen e kom ndi, dridhjen e kom ndi.

Erëmirë Krasniqi: E a mundeni ndoshta me na shpjegu ma shumë për fakultetin? Çfarë lloj përgatitje ka qenë ajo? Edhe ma së pari ndoshta edhe te shkolla e mesme, qysh iu ka përgatit për me vazhdu për arkitekturë?

Shefqet Mullafazliu: E tash osht’ ni... ne jse janë kto detajet e jetës time po po ju tregoj e mandej ju urdhnoni i spastroni diçka. Unë në Prizren si nxanës i gjimnazit kam qenë shembullor, ani që pak hiperaktiv kom qenë, por kom mrrri me i bo mësimet qysh duhet. Për me mujtë me më drejtu në arkitekturë, i ndjeri djali i dajës merr vesh që unë po orientohna në arkitekturë, ai e lutë ni shok të vetin thotë, “Shefqetin lene për riprovim prej matematikës” Arsyeja, thashë. Po ajo paragjykimi, parapëgaditja e tij.

Edhe normal ata shokë kanë qenë, bashkë kanë studiu në Shkup. Ky ka qenë biolog, kurse ai shoku i vet që ishte shok i matematikës. Kqyri unë, befas para se kryhet mësimi në fund të vitit profesori mu m’thrrret, “Urdhno çohu te tabela, bone këtë detyrë, bone atë, bone këtë”, une e boj nifarë gesti. Thotë, “Shko ulu në vend se nuk je mirë, s’e ke bo detyrën mirë”. Kurgjo, kështu ni detal i vogël. Edhe une mbes në riprovim prej matematikës.

E sheh profesori i historisë që Shefqeti mbetet në riprovim prej matematikës edhe historia më la për riprovim. Praktikisht u bo bujë në gjimnaz, Shefqeti në riprovim ka mbetë prej matematikës edhe historisë. Thojshin që Shefqeti ka qenë pak i lazdrum edhe pak si ma energjik. Ashtu thojshin edhe ashtu e pranova. Mandej gjatë pushimeve verore mu m'përgadit profesori Masar Shporta, i cili në nifarë mënyre ka qenë dhandërr i... burri çikës t'hallës. Unë shkoj vazhdimisht te ai për përgaditjet e provimit përmirësues.

Me sukses e kryj, qat' pesëshe që e kom pasë përsëri e marrë pesëshe edhe në histori qashtu e praktikisht qajo përgaditje ka qenë t'u i falënderu djemtë e dajës, i cili ka dashtë me më përforcu në matematikë se ka me u orientu në arkitekturë. E qe qishtu kanë qenë lojnat e atëhershme, që për me na majtë pak ma në nivel mos me ngelë nëpër asi... se vet ka qenë ai student i biologjisë në Shkup, ka përjetu ai qato padrejtësi në Shkup, e tu ditë që unë jom drejtu asi me më forcu. Qikjo o storia, detal i jetës time.

Erëmirë Krasniqi: Qysh ishte shkolla e arkitekturës në Shkup? A ka qenë ma e establishume se ktu në Prishtinë, jo se jo nuk ka pasë...

Shefqet Mullafazliu: Tash dorën në zemër thuja se në atë kohë fort dallim nuk kanë pasë fakultetet në mes veti. Shkolla ma e fortë që është konsideru ka qenë shkolla e Zagrebit, Beogradit, Sarajevës, Ljublanës edhe e Shkupit. Po, ni dukuni ka qenë në Shkup që unë s'kom mujtë me kuptu pse profesorët prej Zagrebit edhe profesorët prej Beogradit ishin në Shkup, po qysh kem pasë marrë vesh na atëherë që u interesoshim, e u flitke, u folke nëpër kullare që krejt ata të dënumt politik që kanë qenë në kohën e Titos...

Erëmirë Krasniqi: Po edhe profesionista.

Shefqet Mullafazliu: Profesionista, mos të them kanë bo pazar. "A don në burg, a don në Shkup?" Edhe qashtu praktikisht, qata profesora që kanë qenë të Zagrebit të cilët vet për veti kanë pasë kry nëpër Vienë e nëpër Europë fakultetet, qata kanë qenë profesorë në Shkup. Prandaj nuk jemi dallu fort prej qendrave tjera universitare. E fati i Shkupit që përjetoi tërmetin, atëherë ne u avansum në njohuritë e strukturës, me fjalë të tjera të dimensionimit dhe të projektimit të strukturës për...

Erëmirë Krasniqi: Për ndërtesa...

Shefqet Mullafazliu: Jo, jo. Të strukturës së objektit për tërmete, të cilët fakultetet e tjera se kanë pasë atë se tash krejt bota synimin e ka pasë në Shkup edhe ekspertët ma të njoftun atëherë të arkitekturës edhe të ndërtimtarisë që vishin në emër të ndihmës në Shkup na ligjërojshin. Kenzo Tange aty ka qenë edhe do profesorë tjerë që tash më kanë dalë prej mendjes e qishtu.

Erëmirë Krasniqi: Domethanë mas tërmetit ai e ka ndërtu atë postën?

Shëfqet Mullafazliu: Mbas tërmetit, me fjalë të tjera krejt qyteti me urbanizëm me krejt mas tërmetit është... ajo ka qenë si të them ndihma botërore...

Erëmirë Krasniqi: Oh, uau sa interesant.

Shëfqet Mullafazliu: E qe qishtë. Bile, bile atëherë që ishte regjistrimi i automobileve SK thojshin “*Svetski Kredit*”, domethanë kredia botërore.

Erëmirë Krasniqi: Po më intereson, e tash a iu çojshin juve si studenta i merrshin këto si raste të studimeve, i merrshit ndërtesat e demolume në fakt prej tërmetit, a qysh?

Shëfqet Mullafazliu: Po, praktikisht kemi pasë edhe si trajnime, si stërvitje, si mësim kemi pasë edhe objektet që kem shku, kem vizitu edhe kem... e na spjegojshin edhe vet profesorët. Ni dukuni ka qenë që është konstatu prej atëherë, prej ekspertëve botnorë, që ka pasë ekspertë edhe prej Indisë që unë në atë ditë në dijen time mendojsha, India, India. Tash në këtë moshë po thom India osht’ fuqi atomike, a une tu mendu në ato filma të Indisë kqyrshim edhe prapambeturi. A praktikisht ata me ni kulturë tre, katër mijë vjeçare.

E na dërgojshin nëpër objekte të rrënune edhe na shpjegojshin se qysh ka ardhë deri te rrënimi i do objekteve ku ka pasë... ku ka qenë ni objekt e objekti tjetër. Njëri ka qëndru e tjetri s’ka qëndru. Arsyeja... tash s’di sa jeni, sa keni informacion të ndërtimit, tregojshin se kur u bo tërmeti në Shkup meniherë si ni kërpudhë e madhe e pluhunit është paraqit në qiell. Arsyeja që objektet kanë qenë të ndërtume në kohnat e nxehta ku suatimi, mallteri meniherë o terë, u tha. Edhe praktikisht prej mallterit ka mbetë pluhuri edhe zalli. Nuk u lidhë mirë edhe krejt ato objekte që në atë kohë kanë qenë të ndërtume gjatë kohës së verës kanë përjetu rrënimë ma tepër, dame ma tepër.

Erëmirë Krasniqi: Sa vjet keni qëndru në Shkup?

Shëfqet Mullafazliu: Po qe prej ‘62-shit, ‘63-shi, ‘64-shi mos të them i perealizum, mandej për pesë vjet kom kry.

Erëmirë Krasniqi: Edhe a mujshit me kuptu qët’ raportin e transformimit që ndodhke a hala nuk u shifke çka o tu ndodhë prej shumë infuzionimeve...

Shëfqet Mullafazliu: A e dini qysh tash? Ni dukuni osht’ në jetën e njeriut që normal edhe prej natyrës së njeriut, po shumë shpejt edhe transformohet edhe pajtohet. Kjo punë o kur s’dini çka me bo atëherë e keni ni drejtim s’keni kah tjetër përmbropa s’guxoni e qashtu. Po e vërtetë është që, tash s’muj me thanë që janë sjellë mirë po u dallojke me drejtimin kur shkojsha me paraqit provimet ose me regjistru

semestrin. Në sportele ata persona administrativ, referentat e çka di une, punonjësit në shërbimin e studentëve tanë kohën në nifarë moskënaqësie t'u na pyt neve, "Pse keni ardhë ktu kur keni fakultetin në Prishtinë?" A unë u drejtojsha thojsha, "Fakultet të arkitekturës nuk ka në Prishtinë". Mandej kom pasë përjetime prej profesorëve që m'pytshin, "Pse po flet ti serbisht? Je në Universitetin e Maqedonisë duhesh me fol maqedonisht". Unë thojsha, "Kurrfarë pengese nuk ka për mu. Kur të mësoj gjuhën maqedone unë ka me fol, se për mu edhe serbishtja edhe maqedonishtja janë gjuhë e hujë. Unë kom kry shkollën në gjuhë shqipe". E po du me thanë që qisi drejtime, pengesa kemi pasë kah pak si studenta të atëhershëm. Edhe për notë besa, nëse kemi qenë për dhetshe ndonjë shtatshe, tetshe kemi marrë.

Erëmirë Krasniqi: E studentat a nuk ishin të përzimë, prej qendrave të ndryshme të Jugosllavisë?

Shefqet Mullafazliu: Po, po, aty dallim s'ka pasë. Kem pasë studenta prej Novi Sadit, Beogradit, Ljublanës e Zagrebit e jo ka pasë. Bile, bile mas tërmetit u dha ni mundësi studentëve të Shkupit, kush ka dëshirë ka me pasë, qysh të them, përparësi edhe lehtësi me u pranë nëpër fakultete besa edhe do provime që janë dhanë me u pranë. Unë u paraqita përsëri në Ljublanë. Po kur më erdh letra kthyse, përgjegja prej Ljublanës, dy-tri provime që pata dhanë në Shkup nuk m'i pranun. Edhe thashë, "Pse me hy rishtaz në asi", ani që kushtet shumë ma të mira ishin në Ljublanë atëherë. Na jepshin vendosje në konvikt të studentëve, ni pjesë të bursit na ipshin, po kur më pengun me provime u tërhoqa.

Erëmirë Krasniqi: E kur u kthytë në Prishtinë? A u kthytë ma së pari në Prizren a qysh ke mandej rrugëtimi prej Maqedonisë?

Shefqet Mullafazliu: Jo, prej Maqedonisë në vitin e fundit konkurova në "Ramiz Sadik" për me marrë bursë se deri atëherë kam qenë pa bursë edhe aprovohet... shumë normal pse produktin gati mos me e pranë, inxhinierin para krymjes. U aprovu prej ndërmarrjes ndërtimore të "Ramiz Sadikut" kërkesa ime për bursë. M'u dha bursa unë vazhdova studimet për ni vjet masi që e mora bursin diplomova edhe isha i obligum edhe vendin e sigurtë kom pasë në ndërmarrje të "Ramiz Sadikut".

Pjesa e Dytë

Erëmirë Krasniqi: Mbetëm te qato ndihmesat të organizatave shoqërore që ua kanë jep studentave. Çfarë sistemi kanë qenë?

Shefqet Mullafazliu: Okej. Sistemi une sa kom pasë njohuri edhe sa kom njohuri atëherë çdo organizatë ka mujtë për kuadrin e vet ni fond të parave me e nda për shkollimin edhe arsimin e punëtorëve të ardhshëm ose punëtorëve që ka ndërmend me i punësu. Me fjalë të tjera ka qenë fond në emën të penzionit, asi stipendionit. Sipas fuqisë ekonomike çdo organizatë atë e ka pasë... le të jetë

organizata për shembull, fabrika e tekstilit ose fabrika e komunës për përpunimin e këpucëve, jo filigrani, jo organizata ndërtimore e qishtu me radhë, edhe komuna.

Normal, u publiku shpallja edhe kanë konkuru njerëzit. Konkurimi ka qenë shumë legal po masandej përzgjedhja a ka qenë a s'ka qenë atë veç ni Zot e din, si gjithkund. Praktikisht edhe komuna ka pasë fondin për llojllojshmëri të profileve. Me mjeksi, me inxhinieri, me çkadi unë krejt me radhë. Unë konkurova në komunë. Mu ma bonën, "Ti s'mundësh me marrë bursë, kështu drejtpërsëdrejti, i keni dyrtë e mdhaja të shtëpisë".

Erëmirë Krasniqi: Çka ka nënkuptu kjo në atë kohë?

Shefqet Mullafazliu: Ka nënkuptu atëherë se baba i ndjerë ka pasë bujtinën në Prizren edhe praktikisht i pasur. Ajo ka qenë familje e cila e ka dashtë arsimimin edhe kanë pa që secili prej nesh po dojnë me u arsimu. Tash me nifarë mënyre pengesë me qenë, e kështu me radhë. E vëllau ka qenë, asi, student i mjeksisë, po të cilin i ndjeri vëlla e ka bajtë e unë kam qenë ngarkesë te baba. Mas katër vjete mandej e mora bursën prej "Ramiz Sadikut" edhe vazhdova.

Erëmirë Krasniqi: Sa vjet ke qenë i obligum me punu për shoqatën?

Shefqet Mullafazliu: Paj, si duket... atë s'kom kalkulu edhe s'kom ditë, po si duket fondi dyfish ka qenë i borxhit. Nëse kom marrë për shembull, në ditë të sotit, shembull po marrim 50 kom vy me i kontribu njiqind mijë për me mujtë me i kthy borxhin. Po une s'jom largu, arsyeja ka qenë se me dhjetë vjet përvojë e fitojsha të drejtën e fitimit të banesës. E masi u vendosa ktu edhe u punësova ktu, ni paragjykim i imi ishte që nesër, masnesër thashë unë sigurisht martohna e kam me pasë fëmi... vet kom vujtë me nifarë mënyre në Shkup gjatë studimeve, fëmitë e mi mos të vujnë ata e kanë fakultetin ktu edhe ma shlirë me vijë shkollimin.

Erëmirë Krasniqi: Qysh ka qenë Prishtina në atë kohë kur keni ardhë? A ju kujtohet?

Shefqet Mullafazliu: Po, Prishtina e mbaj në mend kur kom ardhë, bursin e parë me e marrë u vendosa te ni shok i cili ishte moshanik i imi, ai studiojke ktu ndërtimtarinë. U vendosa në konviktin e studentëve tani që osht'. Zbrita prej autobusit prej Shkupit, u vendosa te ai edhe të nesërmen unë po pys, "Ku osht' drejtorja e 'Ramiz Sadikut'?" Ai m'tregon me gisht prej s'largu thotë, "Qe po duket objekti". Edhe prej qendrës së studentëve, ku është menza e studentëve fushë kollomoqi ka qenë, misri ka qenë. Une nëpër ara kom ecë deri te Biblioteka Universitare e masandej aty ishte kazerma e ushtrisë edhe eca qytetit qysh duhet.

Erëmirë Krasniqi: Hala ka qenë kazerma e ushtrisë në atë kohë? Në cilin vit jemi tu folë?

Shefqet Mullafazliu: Viti '68.

Erëmirë Krasniqi: Domethanë hala nuk osht' bo kampus universitar?

Shefqet Mullafazliu: Jo, jo, jo, jo, jo. Kampusi larg ka qenë.

Erëmirë Krasniqi: Okej. E çka ka qenë? Çfarë lloj bashqe? Çfarë lloj ara?

Shefqet Mullafazliu: Praktikisht livadhe, livadhe hesapi, lloç.

Erëmirë Krasniqi: E ku ka qenë "Ramiz Sadiku" në atë kohë?

Shefqet Mullafazliu: "Ramiz Sadiku" ku osht' tash përballë "Hotelit Iliria", drejtorja aty ka qenë.

Erëmirë Krasniqi: Çfarë organizate ka qenë?

Shefqet Mullafazliu: Organizatë me tetë mijë punëtorë ka qenë, me njëmbëdhjetë reparte të ndërtimit, po du me thonë reparte të llojllojshme. Ka qenë me repartin e ndërtimtarisë, me repartin e rekonstruktimit, me repartin e ndërtimit të ultë e kështu me radhë, me repartin e transportit e qishtë me radhë. Njëmbëdhjetë reparte kanë qenë.

Erëmirë Krasniqi: Çka kanë ndërtu në atë kohë?

Shefqet Mullafazliu: Paj, krejt çka po shihni thuajse "Ramiz Sadiku" i ka ndërtu atëherë. Pak si ma rrallë ka pasë kompani të tjera. Ka pasë Vushtrria, ka pasë Gjakova, ka pasë Gjilani Binačka Morava qishtë me radhë, po kuptohet edhe atëherë ka ndiku pak për me mujtë me majt qetësinë e popullatës. Praktikisht, përparësi ka pasë "Ramiz Sadiku" me marrë punën se tetë mijë veta i ka punësu.

Erëmirë Krasniqi: Ka qenë edhe si kalkulim ekonomik.

Shefqet Mullafazliu: Po, ekonomik.

Erëmirë Krasniqi: Deshta me iu pytë për... kisha dashtë prapë me u kthi te Prishtina, krejt çka iu kujtohet ndoshta. Se ju keni ardhë në nifarë momenti kur qyteti ka qenë tu e ndrru karakterin e vet, domethanë nuk ka qenë ma kasaba otomane po ka qenë tu, tu përjetu nifarë zhvillimi urban. Ju vini bash në momentin kur fillon qajo...

Shefqet Mullafazliu: Veç ka pasë fillu.

Erëmirë Krasniqi: Po de, '60-tat qatëherë.

Shefqet Mullafazliu: Po, veç ka pasë fillu.

Erëmirë Krasniqi: Me “Bozhurin” edhe me qat’ ndërtesën e “Ramiz Sadikut” fillon qyteti modern edhe qaty ndahet me qytetin otoman. A mundeni vizuelisht çka po...

Shefqet Mullafazliu: Ma konkretisht po të tregoj për përjetimin tim e pak ma anena vetëm në kalim kom përjetu atë se s’kom qenë i interesum as me shënu, as me mbajtë në mend se ktu kom pasë çikën e dajës, çikat e dajës, edhe te ata kur kom ardhë kështu... masi me fëmitë e tyre kam qenë moshanik, me ka ni ditë, dy ditë që kam nejtë edhe sa kam mujtë me regjistru. Po, po të tregoj meniherë.

Kur u punësova në “Ramiz Sadik”, kur erdha... normal mu më pranun meniherë, jo me telefon që na erdh ni inxhinier i ri edhe u vendosa me telefon... më drejtoi drejtori gjeneral në Byronë Projektuese ku osht’ [lagjja] “Kolonja e Ramiz Sadikut”, “Qe po na vjen ni inxhinier i ri edhe gjejani vendin” edhe qishte do sene. Arsyeja ka qenë se kanë qenë të obligum me nifarë mënyre, se kam qenë bursist i tyre.

U vendosa edhe tash po duhet unë me qëndru dikund. Aty ka qenë edhe standardi i punëtorëve ku ka qenë edhe menza edhe barakat e strehimit të punëtorëve. Mu m’japin ni çels të ni dhome të barake ku është tash Hotel Prishtina, atje te...

Erëmirë Krasniqi: Krejt në fund ashtu, ma kah “Rilindja”.

Shefqet Mullafazliu: Ma kah “Rilindja”. Aty ni potak i madh ka qenë, ni gropë e madhe, ura prej dërrase. U vendosa une atje, shkova. Shumë normal tash, çka ka me bo tash? Inxhinier, inxhinier po lulet e pranverës nuk janë vetëm te une. Edhe hy me ni dhomë, aty vet i treti me dy punëtorë. Baraka shumë e mirë. U vendosa. Po tash si i ri po du me taku dy tre shokë që i kisha ktu edhe me përjetu qytetin, para “Bozhurit” që ishte atëherë shëtitroja korzo thojshin. Po çka me bo lloç deri në gu.

Erëmirë Krasniqi: Lloç ka qenë aty?

Shefqet Mullafazliu: Lloç ka qenë aty, kurfarë asfalti jo. Une shkoj i blej niparë çizme edhe eci deri në barakë me ato, kur kthehna prej qytetit ku o semafori aty ku o busti Heroinat aty i mshefi une me nifarë qoshi ato çizmet, i veshi këpucë edhe dal në qytet me shëtitë me shokë. Me fjalë të tjera, deri aty ka qenë Prishtina lloç, praktikisht.

Erëmirë Krasniqi: Kur fillon me u konstrukt qito rrugë kryesore që sot e njohin Prishtinën në bazë të tyre?

Shefqet Mullafazliu: Pajj, meniherë qishte domethanë, vitet ‘70-ta me hov pak ma të madh e asi filloi me u ndërtu. Kjo alea që osht’ prej Grandit në drejtim të flamurit ose rreth-rrrotullimit ka qenë me kubza deri te radioja.

Erëmirë Krasniqi: Rreth-rrotullimit po mendoni...

Shëfqet Mullafazliu: Rreth rrotullimit te spitali atje. Domethanë, prej qendrës...

Erëmirë Krasniqi: Ka qenë kalldrëm a?

Shëfqet Mullafazliu: Kalldrëm ka qenë me kubza. E i ndjeri Nazmi Mustafa, kryetar i komunës ishte atëherë, ai me ligjin e atëhershëm... normal nëpërmjet komunës se nëpërmjet votave jo, jep urdhër edhe shtrohet kalldrëma në vazhdim deri te rreth rrotullimi edhe në dy anë mbillen drunjë. Praktikisht, ajo ale ka qenë e para rrugë që është ndërtu deri në fund. Tash, s'di sa kam të drejtë edhe nifarë mënyre mos të del si ironi po boj, shëtishin tash ku është Kampusi i Fakultetit Filozofik edhe Dekanati aty te shkalltë ku o edhe busta e profesor Aganit, aty kullotshin loptë.

Ky me urdhën i konfiskojke, i merrke loptë edhe meniherë në therretore i çojke për me mujtë me eduku njerëzit që nuk o vendi i lopëve ktu, po o vendi i qytetarëve. E po du me thanë, në qat' mënyrë sipas kohës edhe ka përdorë ligjin e qishtu me radhë.

Erëmirë Krasniqi: A ka pasë shumë shpija n'atë anë që e ka mundësu ni jetë blegtorale a prej kahit kanë ardhë?

Shëfqet Mullafazliu: Jo, jo. Rrethi i vogël ka qenë edhe afër ka qenë rrethi. Mahalla e Muhaxherve qaty ka qenë, Mahalla e kjo, qysh e ka emrin për fundi Katedralës? Qaty ka qenë. Praktikisht shtëpiat e...

Erëmirë Krasniqi: Pejtoni.

Shëfqet Mullafazliu: Qaty kanë qenë.

Erëmirë Krasniqi: E bashqet a po iu kujtohen? Ose qito arat me kollomoç?

Shëfqet Mullafazliu: Jo, jo fort. Prej atjehit po. Prej fakultetit, në të vërtetë prej kampusit edhe prej konviktit të studentëve. Po thom, nëpër kollomoç kom ecë.

Erëmirë Krasniqi: E lumi, lumenjtë a iu kujtohen?

Shëfqet Mullafazliu: Lumi m'kujtohet. Para teatrit ka qenë ni urë edhe lumi ka qenë i hapun po unë atëherë fmi kom qenë që kom ardhë te çikat e dajës edhe m'kujtohet ku osht' tash parlamenti edhe objekti i bankës edhe posta e vjetër, aty nisoj kanë qenë do dyçane të ulta sikurse Çarshia e Gjakovës që osht' e Çarshia e Prizrenit që osht' e qaty... bile, bile me nostalgji po i kqyri ato fotografi nëpër arkiva. E i kom rujtë të gjitha fotografitë edhe të Prizrenit edhe të Prishtinës në kompjuter. E

m'kujtohet edhe ajo prej teatrit në drejtim të bankës edhe ku o tash ajo kafeneja Soma a çka osht' në atë drejtim prej asaj anes deri te...

Erëmirë Krasniqi: Kah rruga e gjatë që i kanë thanë a?

Shëfqet Mullafazliu: Po, e rruga e gjatë osht' rruga e ktij, Divanjoll [*Divan Yoli*] i thojshin atëherë, Divanjolli. Divanjolli gjithë ka qenë. Divanjolli gjithë ka qenë.

Erëmirë Krasniqi: Po edhe qajo rrugë është lidhë mandej me Divanjoll.

Shëfqet Mullafazliu: Po. M'kujtohet Dragodani edhe para Pallatit të Rinisë udhëkryqi ku osht' edhe ku osht' tash prokuroria, aty ka qenë lidhja e...

Erëmirë Krasniqi: Shkrimtarëve a?

Shëfqet Mullafazliu: Jo, jo. Po mendoj serbisht qysh ka qenë e po du me përkthi meniherë në shqip.

Erëmirë Krasniqi: Thujeni në serbisht.

Shëfqet Mullafazliu: Lidhja e Automobilistëve ka qenë, drejtorja aty. Aty janë trajnu njerëzit për vozitje edhe kanë marrë leje patent shoferi për... qaty, bash në qosh te udhëkryqi ka qenë. E pak ma mbrapa masandej, përsëri livadh hesapi ka qenë. E Dragodani ka qenë staza e garuesve të motoçikletave.

Erëmirë Krasniqi: E deri kur ka qenë qajo? Krejt i përmendin qito lloj sporte që janë bo aty. Kur kanë fillu me u ndërtu mandej shpijat...

Shëfqet Mullafazliu: Deri, deri, deri '67-shin më duket. Qashtu diçka.

Erëmirë Krasniqi: A kishit mujtë me na tregu edhe diçka ndoshta për kto shtëpiat që kanë qenë të bome prej arkitektëve, osht' nifarë si vale që janë do projekte që zbatohen nëpër lagjet e reja Taslixhe edhe Dragodan. Çka ka qenë ajo? Edhe në Aktash ka plot qasi fenomene, po aty ktu.

Shëfqet Mullafazliu: Ndëgjoni, atëherë une sa e di... se monopolin e ka majtë ai Peciçi, Peciçi, arkitekti Peciç, Dragomir Peciç, Dragomiri ishte, ai e mbajke. Mandej në "Ramiz Sadik" ka qenë Dragan Rodulloviçi, Miroslav Quqanoviçi, Pavle Pavlloviçi. Pavle Pavlloviçi ka pasë punu në BVI për... BVI për, për...

Erëmirë Krasniqi: Për banim a?

Shefqet Mullafazliu: BVI për tokën ndërtimore, atëherë thojshin. Tash ku o, tash ku o prokuroria aty ka qenë drejtorja e tyre.

Erëmirë Krasniqi: Pavle Palloviçi ai e ka pasë ni shpi më doket...

Shefqet Mullafazliu: Te kisha e ka bo shpinë e vet.

Erëmirë Krasniqi: Te cila kishë?

Shefqet Mullafazliu: Te kisha katolike atje te Ulpinana. Atëherë ka qenë shumë edhe e preferueshme edhe na u mundësojke për me shëtitë për me u njoftu me ndërtimin edhe me zhvillimin e arkitekturës në Jugosllavi. Normal edhe nëpër botë po mundësitë kanë qenë të kufizume për me shku nëpër botë edhe ekskurzionet kanë qenë. Lidhja e Arkitektëve ka qenë në funksion, pa marrë parasysh që fondi ynë ka qenë pak ma i dobët, po me nifarë mënyre kem gjetë mënyra për me vizitu edhe me shëtitë.

Erëmirë Krasniqi: Qysh kanë qenë qito udhëtimet studiuese profesionale?

Shefqet Mullafazliu: Udhëtimet studiuese profesionale janë organizu edhe prej Lidhjes së Arkitektëve edhe prej organizatës. E ma së tepërmi që kanë mujtë me organizu me shëtitë ka qenë Enti i Urbanizmit, ku ky Peciçi vet ka qenë drejtor aty. Normal ia ka mundësu edhe vetit edhe arkitektëve të rinjë me shku me shëtitë.

Erëmirë Krasniqi: A po më tregoni, sa më në detaje që mundeni për vendin e parë t'juj të punës, "Ramiz Sadikun" edhe për qat' komunitet që e ka ndërtu "Ramiz Sadiku" si organizatë. Domethanë, edhe keni jetu nifarë forme bashkë, iu kanë sistemu, mandej ka pasë edhe infrastrukturë lagjja, ka pasë edhe...

Shefqet Mullafazliu: Ajo infrastrukturë ka qenë e përmendur edhe ka qenë e shpërblyne atje, ajo zonë, ajo koloni se Miodrag Peciçi ka punu atje në atë koloni... dikur ka punu në "Ramiz Sadik". Edhe ai, ai objekt praktikisht është ndërtu në mbikqyrjen e tij. Tash më ra ndërmend Basarën¹ që pytët herën e kalune praktikisht atë... Basara... objekti i Basarës që është lidhja e LDK-së aty edhe Tiffany, Peciçi i ka kry, i ka projektu. Unë thashë herën e kalune që Basara vet, po më ra ndërmend ma vonë që Peciçi i ka ndërtu.

Erëmirë Krasniqi: A kthehemi te lagja, kolonia.

¹ Svetomir Arsić - Basara (1928) u lind në fshatin Sevcë, të malit të Sharrit. Ai është skulptor dhe prozator serb nga Kosova. Në vitin 1958, ai u diplomua nga Akademia e Arteve Aplikative në Beograd në klasën e Rade Stanković. Arsić ishte anëtar i Akademisë së Arteve dhe Shkencave të Kosovës dhe njihej në Jugosllavi për memorialet e Luftës së Dytë Botërore.

Shefqet Mullafazliu: Po, tash te lagja po kthehem. Lagja ka qenë në nifare mënyre e rrethume... përreth ka pasë objekte të banimit për punëtorët e “Ramiz Sadikut”, normal me familje. E vet Byroja Projektuese edhe ambulanta e “Ramiz Sadikut” kanë qenë me ni oborr edhe bashkë. Atëherë në atë kohë une kur jam punësu, kemi qenë në Byro Projektuese 44 veta. Ni kopjues ka qenë, ni furnizues ka qenë edhe rojtari ka qenë që kemi fol shqip edhe kemi qenë shqiptar. Të tjerët kanë qenë të kombësisë malazeze, sërbe, boshnjak s’ka pasë. Tash mundohna në... po s’muj edhe me gabu. Çeçenoviçi, Dragani, Dragani tjetër, Jova. Njëmbëdhjetë inxhinier kemi qenë të diplomun, vetëm unë kom qenë shqiptar. E mandej ka pasë teknik të profileve të ndryshme, të ndërtimtarisë, të ujësjellsit e kanalizimit, të elektrikës edhe të maqinerisë. Ka pasë edhe ekonomist të cilët kanë punu në...

Erëmirë Krasniqi: Financa, kontabilitet...

Shefqet Mullafazliu: Po, po kontabilitet. Komunikimi ka qenë shumë normal po kuptohet fort me andje nuk na kanë pranë neve, se e kena pengun rehatinë e tyre. S’kanë mujtë në prezencën tonë... ani që kanë fol, po qaq shirë nuk kanë mujtë me fol sikurse në kishë që flasin (qeshë). E kadal kadal masandej u zhvillu punësimi, jo në ndërkohë erdh Esat Mekaj i ndjerë, jo në ndërkohë erdh Lulzim Nixha me Shqipen, jo Salihu erdh. Po, nuk zgjati puna e tyre shumë, shumë normal o edhe gjeishin ma mirë edhe gjeishin poste të ndryshme. A unë i cili kam qenë i obligum me qenë në “Ramiz Sadik” për shkak të bursit u detyrova me duru edhe durova.

Mandej edhe pak ma tepër filloi me u rrit, qysh të them, kundërshtimi ndaj rrethit për me mujtë me ekzistues se mos të del që s’mujta me duru edhe ika.

Erëmirë Krasniqi: E domethanë kjo zyra projektuese nifare forme ka qenë qendra ku ju keni keni projekt, tani qato projektet e juaja janë marrë janë zbatu prej organizatës...

Shefqet Mullafazliu: Qashtu, qashtu.

Erëmirë Krasniqi: “Ramiz Sadiku”.

Shefqet Mullafazliu: Përparësi ka qenë aty... po flas për kuptimin e inxhinierisë e... përparësia ka qenë aty se njeri i cili ka projekt, ka mujtë objektin e vet me shku me përcjellë edhe me pa se si zhvillohet. Ajo ishte normal si ni kënaqësi për inxhinierin me e pa se si po ngritet objekti. Ani që fillimin asnjëherë s’kemi dashë se lloç, po ma vonë masandej ajo pak ma ndryshe po përjetohet.

Erëmirë Krasniqi: Cilat ndërtesa keni punu ashtu ma përafër?

Shefqet Mullafazliu: Ma përafër ka qenë objekti ku o tash Maxi aty te sheshi përballë...

Erëmirë Krasniqi: Rruga te nalt?

Shefqet Mullafazliu: Përballë Kinemasë ABC, Vllaznimi i vjetër kinemaja.... Mandej te Rektorati, ai mas bankësm domethanë banka osht' e mas bankës përsëri ai objekt i naltë që osht' mbi rektorat...

Erëmirë Krasniqi: Pjesa rezidenciale?

Shefqet Mullafazliu: Mbi Rektorat. Bankën s'kom mujtë me përcjellë se shkova në shërbimin ushtarak edhe objektet e tjera qishtu radhë. Kom marrë pjesë në përcjelljen e ndërtimit edhe në ndërtimin e freskusit të Kosovës B, ai objekti... ajo ka qenë kënaqësi për mu, jo si arkitekt i ri po si ni përjetim që ishte teknologjia e parë në Kosovë që e përjetova me e pa se si mundet ni objekt 24 orë pandërpre me u punu. Se ishte teknologjia asi soji që vyke betonin si lumin me e prodhu për me mujtë me ndërtu me atë se ndërprerje s'ka guxu me pasë.

Erëmirë Krasniqi: Pse, çka ndodhke nëse kish ndërpre?

Shefqet Mullafazliu: Nuk lidhet betoni, nuk masivizohet. Objekti o qasi soji e tonë kohën...

Erëmirë Krasniqi: E prej kahit e keni pru teknologjinë?

Shefqet Mullafazliu: Teknologjinë e kanë pasë marrë prej, m'duket francezve, po ka pasë punu ni inxhinier i maqinerisë prej Serbisë. Se prej Francës na kushtojke shtrejtë e normal masandej si gjithkund teknologjia meniherë ose kopjohet ose me marrëveshje mirret edhe me fjalë të tjera kem qenë të zot edhe na me bo qat' punë.

Erëmirë Krasniqi: Sa ka zgjatë?

Shefqet Mullafazliu: Shkurt ka zgjatë, shkurt ka zgjatë. 160 metra janë i ndani në 24 orë. Shumë shpejt u ndërtu, për 12 ditë u ndërtu.

Erëmirë Krasniqi: Tepër shpejt. Në cilin vit është kjo?

Shefqet Mullafazliu: Viti '74, '75.

Erëmirë Krasniqi: Për këtë objektin e Bankosit a muni detajisht me na fol edhe për dizajnin qysh keni vendosë me bo qashtu si flutër, dy ndërtesa, sa ma shumë detaje.

Shefqet Mullafazliu: Po ka qenë, frymëzimi ka qenë pak si student i Shkupit... ku Shkupi ofrojke atëherë pak aventura të arkitekturës edhe guxim edhe si të them durim edhe kritika për t'mirë edhe për t'keq. Se shumë domethanë... ne në botën tonë mendojmë kritik edhe kuptojmë si shamje negative, a kritika është edhe për t'mirë. Edhe në bashkëpunim me kryeprojektantin i cili, iu tregova

herën e kalume, ishte student i Shkupit e që hobi e kishte peshkimin. Ai shkojke në peshkim e mu m'i lejke puntë me i kry. Edhe kur vike ai prej peshkimit, ndonjëherë ose gjatë gjithë kohës që kemi qenë bashkë, korrespondenca shumë profesionale ka qenë që pa kurfarë rezerve edhe ai edhe unë kemi mujtë me asi që, s'ma merr menja që kisha mujtë me përjetu prej dikujt tjetër që ishin aty sikurse prej atij.

Ai a deshti vetën me shpërbly pse une ia krysha puntë ma tepër se që vyjke apo m'pa që nifare mënyre kom ide edhe unem ani që ishte me përvojë nja pesë-gjashtë vjet ma tepër se unë edhe bashkëpunum. E unë ofrova atij, propozova idenë time ma boni, "Prej kah të lindi kjo ide?" Thashë, "Më lindi idea se unë në Shkup kom kry e në Shkup edhe Shkupi u ndërtue. Shkupi në krejt botën po përmendet. Qysh më lindi idea..." E prej atyhit e pranoi qatë edhe praktikisht qashtu. Ai potezi i vogël ka qenë për ditë të sotit...

Erëmirë Krasniqi: Shpjegona çka ka qenë?

Shefqet Mullafazliu: Te udhëkryqi që domethanë prej sheshit Zahir Pajaziti edhe prej kësaj ane të rrugës Garibaldi... se në arkitekturë te udhëkryqet qoshet cungohen. Arsyeja është për mos me u ndërpre vizura e syrit të njeriut edhe mu m'lindi idea qata me propozu edhe ai e pranoi. Po si kundërthanja e asaj vizure edhe me tërhjekë syrin edhe ma tepër une propozova trekëndësh... kështu s'ka kurfarë funksioni po veç osht' si shminkë te ftyra e femres. E pranoi atë edhe qishtu ka qenë që lindi idea. E banka masandej si bankë, janë standarde që s'guxon njeri me dalë jashtë atyre standardeve. Jo sportelet, jo pjesa administrative, jo trezorat poshtë e qe qishtu me radhë.

Erëmirë Krasniqi: E kto vet banka e ka komisionu apo?

Shefqet Mullafazliu: Jo, banka atëherë ka pasë këshilltarin e vet bankier ku na ia kemi spjegu, se literatura ekziston, na kem spjegu në botë qysh janë bankat. Ani që ata, tash dorën në zemër, ani që ata bankierë janë, po kanë shëtitë po për me projektu normal s'kanë ditë edhe s'kanë mujtë. E qe qishtu ka qenë.

Erëmirë Krasniqi: E tani domethanë ai kryesusi në bankë...

Shefqet Mullafazliu: Po tani ai kryesusi, komisionin e kanë pasë e komisioni masandej aprovon e qishtu u aprovu. Ani që edhe atëherë kanë qenë me nifare mënyre kanë qenë konkurset interne. Kem konkuru na, ka konkuru Enti i Urbanizmit, ka konkuru edhe dikushi po na me arsyeshmërinë tonë pak si ma atraktive që ishte edhe u pranu.

Erëmirë Krasniqi: A konkurut si arkitekt i "Ramiz Sadiku", a i pavarun?

Shefqet Mullafazliu: Jo, jo, jo me organizatën projektuese, si "Ramiz Sadik", si "Ramiz Sadik".

Erëmirë Krasniqi: Ah okej, në tanësi osht' bo prej "Ramiz Sadikut".

Shefqet Mullafazliu: Jo, si "Ramiz Sadik". E mandej i ra hise edhe "Ramiz Sadiku" me marrë punën e ndërtimit. Se projekti u aprovu, projekti u bo, por ai projekt, ai objekt u shpallë tash edhe për ndërtim. E tash edhe për ndërtim janë paraqit organizata të tjera ndërtimore të Gjakovës, e të Gjilanit, e Prizrenit e qe qishte me radhë. Po "Ramiz Sadiku" e murr.

Erëmirë Krasniqi: A mundeni me na tregu edhe për materialet që i keni përdorë?

Shefqet Mullafazliu: Po materialet, materialet shumë... normal kanë qenë gjithnji... ka qenë nifarë politike për mos me u shkep përdorimi i materialeve prej jashtë Kosovës. Arsya që interesi ka qenë për me mbajtë mrenda jo vetëm materialet, po edhe prodhustë e materialeve që kanë qenë punëtortë e Kosovës.

Erëmirë Krasniqi: E çfarë materiale të Kosovës janë prodhu?

Shefqet Mullafazliu: Ka, qe për shembull, betoni ka qenë, betoni i yni, cimentoja ka qenë prej Hanit të Elezit, zalli ka qenë prej zallinave tona e kështu me radhë. Vetëm hekurin që kemi marrë prej Zenicës, Bosnës e qishte. Dyrhtë...

Erëmirë Krasniqi: E ai mermeri.

Shefqet Mullafazliu: Mermeri, iu tregova, mermeri... masi patëm shëtitë na që shëtitshim kishim objekte nëpër krejt Kosovën, rastësisht e pamë atë mermer të bukur të Deçanit. E ky projektanti kryesor që ishte ma boni... kom pasë nofkën Sheki atëherë besa edhe tash, ma boni, "Sheki, a p'e sheh çfarë mermeri osht' e qeky mermer është edhe në Kombet e Bashkume në Amerikë", thashë "Aihh le mos bon hajgare", se atëherë edhe ishte edhe s'ishte televizioni në ngjyrna. Tha "Hajt se kur t'paraqesin ndonjëherë ndonjë seancë të Kombeve të Bashkune, shikoje mirë përmbropa si është mermeri". Edhe u binda edhe e aprovum na me qat' mermer me zbukuru qat' trekandsh që është te banka.

Erëmirë Krasniqi: Çfare ka qenë se nuk është ma?

Shefqet Mullafazliu: Po ka qenë si nifarë ngjyre e gjelbërt e mbylltë me do, asi, tekstura të vijave të bardha. S'po di qysh me iu tregu. Mermer i fortë ka qenë, granit.

Erëmirë Krasniqi: A ka qenë lehtë me punu?

Shefqet Mullafazliu: Po kanë punu masanej. U ngjitë, mermeri i trashë ka qenë tre centimetra e diçka edhe me kapë... se me ankera u ngjitë se rrezik prej deformimit të t'fthitit edhe të nxehtit që diletin nëpër ato faqe mermeri edhe ka pasë... ka qenë rrezik mos me u shkputë edhe me ra në asi, mbi këmbësorë.

Erëmirë Krasniqi: Jo iu pyta për mermer se shumë përdoret në qat' kohë edhe krejt fasadat e ndërtesat...

Shefqet Mullafazliu: Po praktikisht edhe Grandi...

Erëmirë Krasniqi: Krejt, edhe Eximkosi që e keni pasë në afërsi m'kujtohet...

Shefqet Mullafazliu: Po, po. Po krejt kto puntë teknologjia e ndërtimit edhe mbikqyrja. Dorën n'zemër me pakujdesi gjithçka praptohet.

Erëmirë Krasniqi: Çfarë projekte tjera keni punu?

Shefqet Mullafazliu: Paj, shkollat i kom bo.

Erëmirë Krasniqi: Cilat?

Shefqet Mullafazliu: Shkollat nëpër krejt Kosovën. 110 shkolla kem pasë fitu për me projektu, prej dy klase deri në 18 klasa.

Erëmirë Krasniqi: A janë variacion i ndonjë modeli të njejtë, a janë të dallushme?

Shefqet Mullafazliu: Të dallushme janë, të dallushme janë sipas terenit, se tereni ka diktuar. Fillimin kem pasë kështu, thuhet njësoj mandej plotësime kanë qenë për çdo lokacion u shtu asi... se klasa si klasë është unike. Dihet sa është gjatësia, sa është gjerësia, sa është naltësia, drejtimi o preferu tanë kohën me kenë jug-lindje, për labotariume e bibliotekë me qenë në veri e qishtë do standarde kanë qenë.

Erëmirë Krasniqi: Po kthehem edhe niherë te "Kolonja Ramiz Sadiku". Po më intereson, sa qëndrut ju i sistemum aty me banu edhe sa keni jetu aty?

Shefqet Mullafazliu: Jo une s'kom banu aty, une kom punu.

Pjesa e Tretë

Shefqet Mullafazliu: Une aty kom punu...

Erëmirë Krasniqi: A, në baraka që...

Shefqet Mullafazliu: Baraka, baraka ka qenë te oborri tash i Rilindjes. Aty, nga dy muaj aty kom banu, masandej m'u dha në gasonjerkë qikaq {tregon me duar} sa qikjo dhomë e juja, në rrugën atëherë u thirrke Marshall Tito, domethanë përfundi Postës së re, ambulanta ku është menihërë objekti i parë.

Erëmirë Krasniqi: Domethanë ato banesa kanë qenë?

Shefqet Mullafazliu: Unë kom qenë në qato banesa qaty. Aty dhoma... unë bile bojsha shaka kur m'pytshin, "Ku po banon?" Thojsha, "Me në banesë prej 13 metra katrorë". Edhe e vërtetë është që ka qenë 13 metra katrorë. Qaty ka qenë hymja, qaty ka qenë tualeti, po në shtrat sa për një person mjaft ishte. Edhe shpejt shkova në shërbimin ushtarak edhe thatë mbeti në vjet. Si u ktheva prej ushtrisë, m'u dha banesa tjetër pak më e gjatë, m'u dha banesa, m'u dha edhe grua e qishtë. (Qeshë)

Erëmirë Krasniqi: Kur e keni taku grunë e ju? Kur keni fillu me kriju familje?

Shefqet Mullafazliu: Po e kom taku para se shkova ushtar. Mandej qishtë korrespondencë kemi pasë, kur u ktheva vazhdim e pas në vjet u martova e që qishtë u kriju familja.

Erëmirë Krasniqi: Po më intereson edhe për situatën politike që ka ndodhë. Po i përmendni do tensione që kanë qenë etnike, me bazë etnike, kur ka ndodhë '70 e... jo '70 e po...

Shefqet Mullafazliu: '81-shi.

Erëmirë Krasniqi: '81-shi. A u reflektu edhe në ambientin e punës?

Shefqet Mullafazliu: Eh, '81-shin unë akoma isha në Byronë Projektuese të "Ramiz Sadikut" edhe pak veta patëm mbetë se njerëzit ishin shpërndarë. Ma "Ramiz Sadiku", kadal kadal filloi m'u fikë në nifare mënyre të them. Edhe organizohen demonstratat e '81-shit... qaty në qendër menihërë mas Eximkosit, "Ramiz Sadiku" këta punëtortë e mi, po them punëtortë e mi, bashkëpunëtortë e mi që ishin, unë qaty isha ma në vjetri, kishte edhe serbë edhe shqiptarë. Interessant është se punën që e kryeshim na shqiptartë, jo pse u ndamë na vet, por ishin edhe profilet që ishin të ndamë në dy salla.

Serbtë ishin me elektroteknikë e maqineri edhe me strukturë e statikë në në sallë se ishin serbë, a na të arkitekturës edhe të projektimit ishim në në sallë tjetër. Çdo mëngjes qysh ka qenë atëherë me nifare rregulle të jetës. Në ora 9:00 dilshin në kaftjall. Femrat dilshin pak nëpër shitore, pak andej edhe në ora

9:30 secili vijke u nënshkrujke edhe vazhdojke punën deri në ora 14:00. Se “Ramiz Sadiku” ka punu shtatë ditë, po du me thanë, gjashtë ditë. Edhe të shtuneve kemi punu po prej 7:00 deri në 14:00, vikend nuk kemi pasë na.

Erëmirë Krasniqi: Edhe hajshit edhe... qaty në menzë krejt apo?

Shefqet Mullafazliu: Jo, jo. Kush dojke shkojke në menzë kush dojke dilke për veti në regji të vetën u furnizojke, merrke edhe hajke. U bonën demonstratat, qaty kanë qenë edhe ekonomistat në objektin tjetër që i takojshin pjesës ekonomike të “Ramiz Sadikut” për llogari të rrogave edhe kontabilitetit. Unë si udhëheqës, fillun... fillojnë trazirat edhe ata të gjithë vrapojnë edhe frikohen edhe kthehen meniherë qaty prej radios... para radios që janë furnizu me, m’u ushqy, vijnë edhe secili janë frigu. Nuk kem pasë ide na që po bohet diçka.

E ata kanë ditë, sërëbtë e kanë ditë, se kanë pasë, qysh të themi, informatat edhe lajmet paraprake të përgaditun ose... kanë ditë. Edhe fillon njëri prej atyre... unë i dëgjoj si është ma mirë me za, “Kqyrni Sheki a është aty mos ka dalë edhe ai, se ai osht’ i parehatshëm”, për mu. Unë dëgjoja, ai nuk din që unë jom në zyre. Zyrja, qysh ka qenë tavolina ime dera ka pasë qëllu që kur të hapet dera nuk doket tavolina se... “A nije tu, nije tu”, “Nuk është aty, nuk është aty”.

Praktikisht kanë fillu me mledhë material për me përndjekë, kurgjo. Kta të tjetër vijnë iu thom, “Hiç mos dilni kërkund, rrini ktu rujeni vetën se s’dihet prej ktyne çka pret njeri”. Edhe me nifarë mënyre qashtu pshtum na prej sulmit të tyre, prej sulmit të tyre jo prej, si të them...

Erëmirë Krasniqi: Prej asaj që ndodhke jashtë...

Shefqet Mullafazliu: Po. Edhe po du me thanë se kanë qenë... gjithnjë ni ftofje e marrdhanieve ka ekzistuar në atë kohë. U përgaditshin ata për atak e na tonë kohën... pakicë kemi qenë në atë kohë në lagje, si punëtor e si bashkëpunëtor e qishtu. A din, gjithnjë e kanë pasë... e vërtetë është që Byroja Projektuese, Enti i Projektimit i “Ramiz Sadikut” o konsideru si truni i “Ramiz Sadikut”. Se praktikisht, ideja prej atyhit ka lindë. Nuk po nënçmojmë na edhe ndërtimet tjera edhe... po zanafilla, laboratoriumi i punës aty ka qenë.

Erëmirë Krasniqi: A është qaty... kolonia a është një prej mahallave, prej kahit edhe fillon me u ndërtu edhe krejt qyteti? A kishim mujtë qashtu me fol për to?

Shefqet Mullafazliu: Jo, s’kisha mujtë ndoshta me thanë qashtu po interesimi ka qenë i vetë njerëzve që ajo lagje poshtë që osht’ mas... domethanë, qysh të them... si i thojsin asaj lagje? Pasma harro.

Erëmirë Krasniqi: Qyteza Pejton.

Shefqet Mullafazliu: Qyteza Pejton, qyteza Pejton. Ka qenë ni lagje e rregullume prej kohësh. Se ai Miodrag Peciçi ka pas bo zgjidhjen urbanistike atëherë.

Erëmirë Krasniqi: Aha, për Pejtonin.

Shefqet Mullafazliu: Për Pejtonin. Për qata çdo shtëpi e ka oborrin e vet, e ka hymjen qysh i takon ni qytetit, nuk ka pasë... besa, besa edhe s'kanë guxu kush qysh ka dashtë me ndërtu. Se ka qenë parim edhe ligj edhe përcjellje prej anës së ndërtimit prej komunës.

Erëmirë Krasniqi: Domethanë, ka qenë nifare lloj standardi ni kat, dy kat shpijat.

Shefqet Mullafazliu: Po, po, po. Mandej për me mujtë me mbindërtu përsëri u dhanë leja prej komunës që kush ka mundësi me mbindërtu, po jo me qef të vetin por me pëlqim të projektantit ose projektit.

Erëmirë Krasniqi: I kom edhe dy pyetje rreth “Ramiz Sadikut”. Ndoshta kisha dashtë me fol ma shumë për... se ata kanë ndërtu edhe nëpër Jugosllavi, nëpër... jo veç në Kosovë...

Shefqet Mullafazliu: Po, po, po.

Erëmirë Krasniqi: Edhe pytja e dytë, masnej ndoshta me shku drejt qasaj qysh ndoshta ka fillu me u shu si organizatë ose edhe qysh u kriju “Gradingu” si organizatë alternative e “Ramiz Sadikut”. Po nashta qito dy pika me i prekë.

Shefqet Mullafazliu: “Ramiz Sadiku” ka ndërtu edhe jashtë Kosovës. Ka pasë punëtorë edhe në Bagdad, ka pasë punëtorë në Libi, ka pasë punëtorë në Çeki. Kem qenë të thirrur edhe në Gjermani edhe në Çeki me ndërtu qasi freskus për sillosa, po du me thanë, termoelektrana. Urat në rrugën e bregdetit në drejtim të Ulqinit i ka ndërtu “Ramiz Sadiku”, urat në drejtim të Shkupit do do i ka ndërtu “Ramiz Sadiku”, motelin te Ujëmani atje. Projektin e motelit unë e kam bo, domethanë në drejtim të Malit të Zi ku shkohet prej Mitrovicës, unë kom projektu.

Tjetër, ka qenë ni lagje e parapame me 610 shtëpiza në afërsi të Ulqinit për punëtorë të cilën nuk mujtëm me realizu. Arsyeja që u bonën trazirat, u bonën ndryshimet politike e çka di unë. E na patën dhanë atë lokacion me qëllim që praktikisht ka qenë knetë, po na tu pasë fuqinë ekonomike edhe fuqinë e punëtorëve, mekanizimin u pajtum me bo urbanizimin e asaj lagje si Kamenova, pushimorja që ka qenë në afërsi të Budvës. Kur u bo tërmeti me 1979, atëherë qajo lagje që ishte e parapame për pushimet e punëtorëve të Kosovës, shërbeu për strehim të atyne të pastrehëve që përjetun tërmetin në Malin e Zi. Edhe kurr ma çka u bo ma tutje nuk kam ide veç e di që edhe qato kanë fillu me ndërtu edhe e krym po për përdorim nuk mujtëm me mbërri me dhanë leje.

Erëmirë Krasniqi: Domethanë, keni pasë edhe për pushimore të ndryshme në vende bregdetare?

Shefqet Mullafazliu: Kemi pasë pushimore në Kamenovë edhe në Ulqin, kemi pasë.

Erëmirë Krasniqi: Në Kroaci?

Shefqet Mullafazliu: Në Kroaci organizatat tjera kanë pasë. Qe banka për shembull ka pasë përballë ku kom përjetu me shku, përballë Dubrovnikut Ishulli Lupus. Edhe nëpër Kroaci, në Hvar kemi pasë, edhe në... po du me thanë, si organizata të Kosovës, në Opati, jo po në afërsi të Pullës, ato vendet e vogla.

Erëmirë Krasniqi: E kjo si ni shërbim shtesë që organizata ua ofrojke a?

Shefqet Mullafazliu: Jo nuk ka qenë, po ka qenë kinse puntortë të cilët s'kanë pasë fort mundësi ekonomike e të ciltë punëtorë të Kosovës kanë pasë shumë fëmi, normal s'kanë mujtë me përballu pushimin atëherë si ndihmesë ka qenë. U ka dhanë atyne përparësi me përdorë, transporti ose i tyre ka qenë ose i organizum ka qenë edhe kanë përdorë. Normal na ka ra hise edhe neve, drejtorëve e udhëheqësve masi që kanë asi... se shpesh herë dikushi ka marrë e qysh të them... terminin për me përdorë po s'ka pasë mundësi me shku, masandej u bo ndrrimi me pëlqim të dyanshëm.

Erëmirë Krasniqi: A ka pasë edhe gazetë "Ramiz Sadiku"?

Shefqet Mullafazliu: Ka pasë gazetë edhe... ka pasë gazetë, bile, bile m'u pat' dhanë rasti derisa isha student i arkitekturës në Shkup, m'u dha, qysh të them...

Erëmirë Krasniqi: Ke qenë i ftum me shkru?

Shefqet Mullafazliu: Jo, që kom qenë i ftum po kom pasë aty ni shok i cili u mirrke me gazetari, ma ofroj tha, "Shefqet, a po vjen me qenë korrektor teknik i gazetës 'Ramiz Sadikut' masi je i Prishtinës?" Ma boni. Thashë, "Pse jo?" Ni honorar i mirë, pat' qëllu edhe konvikti i studentëve ku banojsha edhe shtypshkronja e Maqedonisë që ishte qaty përballë. Edhe ni herë në javë shkojsha bojsha korrekturën edhe ni honorar të vogël e merrsha.

Erëmirë Krasniqi: A iu ka mbetë najnjo prej tyne?

Shefqet Mullafazliu: Jo, jo, jo. Tash kur po kqyri qito broshurat, revistat e arkitekturës u mundova me ia dhanë jo fakultetit, jo atë nuk i deshtën edhe u detyrova me ia dhanë njënit. Tash po shoh, nëpër shesh po shiten qito librat e mia. Po mirë është përsëri që po shiten. (Qeshë)

Erëmirë Krasniqi: (Qeshë) Ndoshta është e juja.

Shefqet Mullafazliu: Nuk është çudi. Qajo po {tregon me gisht} qajo, qajo me shkronja. Me siguri, se s'ma merr menja që dikush...

Erëmirë Krasniqi: Jo, jo kta në shesh e kom ble, më interesojke çka ka ndodhë. Që don ja u jep. (Qeshë)

Shefqet Mullafazliu: Jo, jo une i kom dhanë. Bile, bile masi e keni qitu, mos ndoshta edhe po gjej ndonjë e t'ju sjelli. Se a dini qysh? Dorën n'zemër s'po muj me dhanë diku ku s'mundet me u përdorë. Tash po iu tregoj edhe storien e fëmive t'mi, vajzave, që u regjistru në arkitekturë e kurrë s'mujti me i kry. Jo pse s'deshtëm, po pse deshti situata edhe politike edhe jetësore.

Vajza e madhe, kur konkuroi për arkitekturë unë thashë, “Pse babë? Çka po don? A din që ti femën je, nesër masnesër ki me pasë krejt tjetër obligimet familjare sesa mashkulli. Unë si mashkull s'po mrri ndonjëherë me bo e lemo ti me fëmi nesër masnesër”. Edhe me nifarë mënyre me dy fjalë më bindi, “Babë...” tha, “ti me 20-30 vjet që ke investu, ke ble libra e mjetet e punës e krejt. Unë kudo që drejtohna duhna prej fillimit me bo. Pse? Tu pasë une gati krejt sendet e mos me studiu arkitekturën”. U pajtova edhe u regjistru. Po kërsiti lufta, u bo.

E dyta qashtu që edhe ma tepër vunë ajo, është në Amerikë. Konkuroi në arkitekturë. E për mos me mbetë pa u regjistru se ishte konkurenca e madhe, konkuroi edhe në dizajnin grafik. Në dizajnin grafik, pranimin pranues fillojke në ora 8 deri në ora 12 kurse në arkitekturë fillojke prej orës 11 e ma vonë. Kjo shpejt e shpejt u paraqitke atje, punojke sa punojke dilke para kohës une me automobil e çojsha në Dragodan për me vazhdu e praktikisht qashtu edhe fitoi pranimin në arkitekturë edhe filloi me studiu arkitekturën.

Po u bo lufta, prej Shkupit që ishim të largum prej ktuhit, gjeti të dashurin e vet në Amerikë me telefon e me asi, u gjetën si u gjetën, hyi aeroplanit edhe u bashkun atje. E praktikisht edhe njëna edhe tjetra janë pa asi, pa e kry. E mandej ajo në Amerikë e vazhdoi elektroteknikën e boni mastër atje edhe... po veç vunë, vunë.

Erëmirë Krasniqi: E qysh filloi me u shu “Ramiz Sadiku”? Te mshelim edhe këtë temë...

Shefqet Mullafazliu: “Ramiz Sadiku” filloi me u shu se ishte interesi i ni drejtori teknik i cili ishte në të njëjtën kohë edhe mësimdhënës në Fakultetin e Ndërtimtarisë në gjuhën serbe, serbo-kroate. Edhe interesi i tyre ishte që “Ramiz Sadiku” kadal kadal me u shu për me mujtë ata, çka di unë planet e tyne qysh ishin edhe praktikisht na mbetëm kështu, sikurse në vjeshtë që binë gjethet kadal kadale m'u shkapërderdhë, m'u shpërnda personeli.

Erëmirë Krasniqi: Në cilat vite kjo?

Shefqet Mullafazliu: Ajo është viti '82-'83. Mandej '83-shin unë konkurova në Bankën e Bashkume, praktikisht unë kom qenë i fundit... në Byro të Projektimit po flas, prej udhëheqësve që jom largu. Mas meje masandej u shpërndanë.

Erëmirë Krasniqi: Në cilin vit keni kalu në Bankën e Bashkume?

Shefqet Mullafazliu: '83-shin.

Erëmirë Krasniqi: Sa keni qëndru aty? Derisa...

Shefqet Mullafazliu: Derisa Millosheviçi nuk më përjashtoj.

Erëmirë Krasniqi: '91.

Shefqet Mullafazliu: '90 e...

Erëmirë Krasniqi: Çka keni bo mandej?

Shefqet Mullafazliu: Kurgjo mandej...

Erëmirë Krasniqi: Çka ka ndodhë me juve mandej?

Shefqet Mullafazliu: Kurgjo, mandej fillova qitu afër qisaj hymje, lypa pëlqimin e ni shokut që e kishte lokalin e vet si market. Aty shërbeva. Arsyeja mos me nejtë në shpi se e disha nëse mbes në banesë, atëherë kerkush nuk më njeh edhe harrohet njeri. E kështu në kontakt me njerëz ma ndryshe. Shërbeva aty sa shërbeva edhe isha në kontakt jo me të ndjerin Rexhep Luci, jo shoqnia që rrishim e kontaktojshim me njoni tjetrin edhe u punësova me ni firmë private. Aty pak ekzistova, mandej, ndrrova firmën private vazhdova...

Erëmirë Krasniqi: Firmë të arkitekturës a çfare?

Shefqet Mullafazliu: Jo, jo. Asi të ndërtimtarisë. Mandej me ni firmë private tjetër vazhdova. E pashë që po më keqtrajtojnë... se interesant është, njerëzit të cilët nuk kanë njohuri të profesionit u pengon atyre profesionisti, ani që kanë nevojë, po u pengon. Edhe unë tash jom njeri që kom jetu, na përgatitshin edhe neve arsimtarte, profesorët tonë në fakultet. Thojshin, "Ndëgjoni, ju jeni inxhiniera po keni me pasë raste që prej punëtorit ma të thjeshtë keni me pasë ofendime edhe nënçmime, por niveli i tij është asi soji që ju duhni me përballu, me tejkalu ose me anashkalu momentin". Por, veç unë normal masi që isha nevojtar për me punu, për me ekzistu familjarisht durova sa durova veç e pashë

që po tepron. Diagrami u ngritke edhe i dhashë pikë diagramit edhe u tërhoqa. Mandej, krisi lufta shpejt...

Erëmirë Krasniqi: Ku keni qenë gjatë luftës?

Shefqet Mullafazliu: Gjatë luftës kam qenë në Shkup familjarisht. Nuk kom dashtë kërkund me shku përveç që kom pasë orientimin ose në Kanadë ose në Suedi, në Gjermani nuk mujta se s'kom pasë kërkënd. Edhe u vendosa si u vendosa. Vajzat ishin tu punu në kufi, pasi e zotërojshin gjuhën angleze derisa nuk u zgjedh problemi i vajzës t'vogël për me i hypë aeroplanit me shku për Amerikë. E unë, gruja, vajza madhe edhe djali mbetëm në Shkup.

Djalin e regjistrova në shkollë atje për me vazhdu shkollën, për mos me mbetë rrugëve, e vajza punojke në kufi si përkthye me ushtrinë finlandeze. Erdh koha u kthym, jeta vazhdoi, vajza u punësu. Une u punësova me ndërkombëtarë me Kryqin e Kuq Danez si ekspert, si arkitekt që jepshim ndihma... nja 440 shtëpia individuale i kom inçizu e riprojektu e kemi dhanë ndihma. Në ndërkohë edhe ata nuk u durojshin, fort kryeneçë, se fort edhe unë kom duru... e vërtetë që ndihmë jepshin po konsiderojshin që na jemi edhe të pazotë edhe të paaftë.

Dikur kalova në Kryqin e Kuq Norvegjez. Në Kryqin e Kuq Norvegjez ata e kishin program renovimin e... aftësimin e shkollës së mesme të bujqësisë në Lipjan. Aty qëndrova ni kohë të gjatë, projektova qato kthinat e shkollës që ishin si fermë, e si shkollë e si sallë të mësimi e do sene. E qe qishtu. Pas atyne masandej... në ndërkohë, paralelisht në të vërtetë u pranova në Fakultetin AAB si mësimdhënës, ligjërova...

Erëmirë Krasniqi: Ju keni ligjeru...

Shefqet Mullafazliu: Kom ligjërë.

Erëmirë Krasniqi: '70-tat, '80-tat si asistent.

Shefqet Mullafazliu: Po si asistent atae, po gjatë "Ramiz Sadikut" ajo ishte. E knena në AAB ligjërova sa ligjërova dikur hajnia erdhi e qe qishtu, vyjke kuadri me u përtri e qishtu.

Erëmirë Krasniqi: Kur jeni pensionu?

Shefqet Mullafazliu: O jom pensionu para dhjetë vjetëve. Para dhjetë vjete jom pensionu. A atë t'ju tregoj, derisa kam qenë si projektant i bankës e që shkova në Shkup si ushtar pas kthimit nga ushtria meniherë u pranova në Fakultetin e Arkitekturës, jo, të Ndërtimtarisë si asistent. Në ndërkohë u hap arkitektura, aty si asistent e ligjerues e qishtu.

Erëmirë Krasniqi: Kë e asistojshit?

Shefqet Mullafazliu: Profesor Skender Hasimën.

Erëmirë Krasniqi: Skender Hasimën?

Shefqet Mullafazliu: Skender Hasimën.

Erëmirë Krasniqi: Ai është njëri prej arkitektëve t'parë apo?

Shefqet Mullafazliu: Jo, para meje ai ka qenë, profesor Bashkimi ka qenë.

Erëmirë Krasniqi: Po, qikjo gjenerata.

Shefqet Mullafazliu: Po, po, po, po. Qemal Nallbani ka qenë, Mejdi Raci ka qenë e unë mas tyne. Ani që me Mejdi Racin bashkë e kemi kry se ni gjeneratë në studime kemi qenë.

Erëmirë Krasniqi: A keni diçka për me shtu? Se mu po më doket që e kemi mbri fundin e tregimit.

Shefqet Mullafazliu: Kurgjo, urdhnoni ju pytni.

Erëmirë Krasniqi: Diçka që se kemi përmend. Çka boni sot?

Shefqet Mullafazliu: Sot qishtu, sot sa muj rri në kompjuter, ani që shumë kushi, tash po flas për vetën time, shumë kushi u çuditke, “Çka po rrin? Çka po t'vyn?” “O po du me përcjellë të arriturat e dizajnit të arkitekturës”. Unë kur kom vizatu, kom vizatu me ditë t'tana me muj t'tana, me javë t'tana tash kompjuteri me disa minuta me disa orë po ma bon projektin qysh kom qef edhe meniherë po përjetoj në 3D me pa edhe në këto sende. Po normal...

Erëmirë Krasniqi: A projektoni hala?

Shefqet Mullafazliu: Po projektoj veç nuk më pagujnë. Prandaj nuk projektoj, nuk projektoj (qeshë). E mirrna, mirrna me vizatim. Akuarielin e du vizatoj akuariel e qishtu.

Erëmirë Krasniqi: A është diçka që keni fillu s'fundi a?

Shefqet Mullafazliu: Jo, gjithë kom dashtë akuarielin. Edhe harrova me iu tregu, masi që dola prej bankës mbeta pa punë, si ju thashë ma herët kom qenë i parehatshëm gjithë e kurrë s'kom pritu me punu. S'kom zgjedhë punën, ma mirë me punu se me të injoru dikush. Fillova me dizajnimin e gipsit edhe punojsha dekorimet e enterierit. Vet prodhojsha, vet bojsha që ka qenë risi në Kosovë që njerëzit

shumë në mënyrë ma primitive punojshin e unë vet i bojsha dizajnet, vet i bojsha kallëpat, vet prodhojsha e qishtu me ni shok të ndjerë punojshim.

Erëmirë Krasniqi: Në çfarë stili a çfarë shtylla ishin ato?

Shefqet Mullafazliu: Edhe shtylla edhe dokoracione edhe figura qysh të them asi... a dini pse? Se kom pasë rast shumë me shëtitë, kom pasë rast shumë me pa. Kom pa në Poloni, kom pa në Rumuni, kom pa në Turqi, kom pa në Austri, asi, mirë thashë Austri e Francë punën qysh e bojnë dokoracionin e gipsit. Po masi me nifarë mënyre muj me thanë lirisht vetit jom shpirt artistik, m'ka tërhjekë edhe durtë e majta nuk i kom pasë po dy durtë e djathta i kom pasë. Kom mujtë me dizajnu edhe kom bo se e kom njoftë teknologjinë e gipsit edhe kom bo. Kom bo kallëpat e gipsit vet prej...

Erëmirë Krasniqi: A kishit ndonjë punëtori a qysh?

Shefqet Mullafazliu: Po në bodrum qikaq {tregon me duar} ni kthinë e kom pasë, qaty punojsha. Msheft punojsha se s'guxojsha, ni sërë kom pasë mbi bodrum atij i pengojsha. E qishtu presion bojke me liru une bodrumin e qishtu do...

Erëmirë Krasniqi: Po a?

Shefqet Mullafazliu: Kom pasë bo korreliefin e presidentit Ibrahim Rugova edhe e shumëzgjasha atë me atë gjallnojsa, shitsha bustin e qishtu.

Erëmirë Krasniqi: Çka është korreliefi?

Shefqet Mullafazliu: Korreliefi osht' praktikisht jo fotografi po fotografi e reliefume.

Erëmirë Krasniqi: E keni bo për rezidencën e tina a...

Shefqet Mullafazliu: Jo, jo, jo. Une për veti e bona. E nisa për 28 nëntorin me bo Ismail Qemailin, kjo është '90-të e... n'qitë shitore qitu ku punojsha, kur pashë që s'po muj me qëllu Ismail Qemailin m'dilke si Lenini atëherë... po unë s'mujsha me bo. Atëherë u ofru 28 nëntori, thashë pse s'e boj une kryetarin, qitu ishte afër te Tifania thashë po shkoj po marr une fotografitë e tij. I mora fotografitë edhe prej fotografive kadal kadal edhe e bona. Kur tregova do shokve që janë profesionista e artista e aktorë ma bonën, "Jo ti ia paske qëllu me ka krejt". Atëherë m'dhanë vullnet une e bona kallëpin prej silikoni fillova me prodhu prej gipsit, me ngjyrosë po di edhe qishtu ekzistojsha.

Erëmirë Krasniqi: Shumë interesant. E në cilin vit ke kjo, se dy herë nisët me m'tregu, 19...

Shefqet Mullafazliu: Cili?

Erëmirë Krasniqi: Kur e keni prodhu qit korreliefin.

Shëfqet Mullafazliu: '95-shin.

Erëmirë Krasniqi: Në çfarë momenti ka qenë Rugova qatëherë? A ka qenë kyç?

Shëfqet Mullafazliu: Jo, qitu ishte po edhe ishte edhe s'ishte. Ka pasë presione e qishtu. Po, qeshtu afërsia më inspiroi.

Erëmirë Krasniqi: Zotëri Shëfqet unë e kisha mbyllë qitu intervistën.

Shëfqet Mullafazliu: Faleminderit shumë.

Erëmirë Krasniqi: Shumë faleminderit.